

Date 17/01/2026

KONTRATË DHURIMI

Sot, më date 17/01/2026, palët e mëposhtme lidhin këtë kontratë dhurimi:

DHURUESIT

- **Zj. Sandra Petrauskiene**, e datëlindjes 28/03/1983, shtetase shqiptare, lindur në Klaipeda dhe banuese ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me Nr. CA08647FO.
- **Z. David Ferrari**, i datëlindjes 08/04/1980, shtetas italian, lindur në Civita Castellana dhe banues ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. AZ1764154.
- **Zj. Dorjana Kafeja**, e datëlindjes 16/05/1983, shtetase shqiptare, lindur në Memaliaj dhe banuese ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit me Nr. Personal I35516070E.

PRANUESIT

- **Z. Erasmo Cipriani**, i datëlindjes 07/09/1955, shtetas italian, lindur në Roccagorga dhe banues ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr.CA62379QB.
- **Z. Alentin Dervishi**, i datëlindjes 17/09/1975, shtetas shqiptar, lindur në Tirane dhe banues ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit me Nr. Personal H50917097N.

Të lartëpërmendurit janë madhorë me zotësi të plota juridike të cilët hartojnë këtë kontratë dhurimi të kuotave si më poshtë:

- Dhuruesja **Zj. Sandra Petrauskien** është ortak e shoqërisë VA.NI.CA Holding sh.p.k. një shoqëri e regjistruar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi me NUIS M51512006E, ku zotërojnë 1 (një) kuote të kapitalit të kësaj shoqërie në masën 25%. Nga kuota që zotëron **Sandra Petrauskien** në shoqërinë e mësipërme i dhuron **Z. Alentin Dervishi** 1 (një) kuotë të shoqërisë me vlerë nominale 2,000 (Dymije) lekë, e cila përfaqëson 2% të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe **Z. Erasmo Cipriani** 1 (një) kuotë të shoqërisë me vlerë nominale 23,000 (Njezete e tremije) lekë, e cila përfaqëson 23% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- Dhuruesi **David Ferrari** është ortak i shoqërisë VA.NI.CA Holding sh.p.k. një shoqëri e regjistruar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi me NUIS M51512006E, ku zotëron 1 (një) kuote të kapitalit të kësaj shoqërie në masën 24%. Nga kuota që zotëron **David Ferrari** në shoqërinë e mësipërme i dhuron **Z. Alentin Dervishi** 1 (një) kuotë të shoqërisë me vlerë nominale 24,000 (Njezete e katermijë) lekë, e cila përfaqëson 24% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

VA.NI.CA. Holding

M51512006E

- Dhuruesja **Dorjana Kafeja** është ortak e shoqërisë VA.NI.CA Holding sh.p.k. një shoqëri e regjistruar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi me NUIS M51512006E, ku zotëron 1 (një) kuote të kapitalit të kësaj shoqërie në masën 3%. Nga kuota që zotëron **Dorjana Kafeja** në shoqërinë e mësipërme i dhuron **Z. Erasmo Cipriani** 1 (një) kuotë të shoqërisë me vlerë nominale 3,000 (ptremijë) lekë, e cila përfaqëson 3% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Pas përfundimit të dhurimit, shpërndarja e kuotave dhe kontributi i ortakëve në shoqëri do të jetë si më poshtë:

- Z. Erasmo Cipriani** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- Z. Alentin Dervishi** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, e cila përfaqëson 19 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Pranuesit e dhurimit deklarojnë se pranojnë dhurimin e pjesës së kapitalit themeltar që i dhurohet nga **Zj. Sandra Petrauskiene, Z. David Ferrari dhe Zj. Dorjana Kafeja** në shoqërinë VA.NI.CA. Holding sh.p.k., dhurim ky që i bëhet pa ndonjë shpërblim material apo monetar.

Me lidhjen e kësaj Kontratë Dhurimi, palët në të marrin dijeni se dhuruesit e humbin të drejtën e pronësisë të pjesës së kapitalit të dhuruar në shoqërinë VA.NI.CA. Holding sh.p.k. dhe nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi kapitalin e dhuruar. Kjo kontratë do të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

Kontrata e dhurimit u redaktua në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Palët deklaruan se ky dhurim është bërë me vullnet të plotë dhe pa kundërshtpërblim.

Kontrata e mësipërme si u lexua nga ne palët dhe u pa se në të është shprehur dëshira e vullneti i lirë dhe i plotë e nënshkruajnë pa vërejtje.


Dhuruesit

Sandra Petrauskiene




David Ferrari

Dorjana Kafeja



Pranuesi i Dhurimit

Alentin Dervishi




Erasmo Cipriani



VA.NI.CA. Holding

M51512006E